

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE
DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA TEKNIKE EKONOMIKE TIRANE

Nr 943 Prot.

Tiranë, më 04.10.2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË Ë MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019. “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; të Udhëzimit Nr. 14, datë 27.5.2021, Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimtarinë e Ofruesve Publikë të Arsimit dhe Formimit Profesional”, Neni 11.3, pika “e” shkolla Teknike Ekonomike Tiranë ju njofton krijimin e vendit të lirë për vitin shkollor 2023-2024 në pozicionet:

1. 3 (tre) mësimedhenes të kultures profesionale (teori dhe praktike profesionale me kohe të pjesshme në drejtimin Ekonomi-Biznes.

2. Kriteret e marrjes në punë:

2.1 Kriteret të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.


2.2 *Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim të mesëm profesional:*

- a) të ketë diplomë të nivelit master professional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
 - b) të ketë të paktën 3 (tre) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
 - c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
2. Dokumentet e aplikimit:
- a) letërmotivimin për pozicionin;
 - b) jetëshkrimin (CV-në),
 - c) kartën e identitetit;
 - d) diplomën;
 - e) librezën e punës;
 - f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
 - g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
 - j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
 - k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

3. Afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentacionit në protokollin e shkollës Teknike Ekonomike Tiranë është 18/10/2023

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTOR

Dr. ANILA NANAJ